

RIKONSTRUKSION I OBJEKTIT PANDRYSHIM FUNKSIONI

RELACION ARKITEKTONIK

OBJEKTI:

RIKONSTRUKSION I GODINAVE TE BANIMIT:

ADRESA:

BASHKIA KAMEZ

RELACION TEKNIK

Objekti i ketij relacioni eshte per Rikonstruksion Pandryshim Funksioni i banesave per personat ne nevoje sipas listes bashkengjitur, banuese ne Bashkine Kamez. Objektet ne fjalë jane te demtuara dhe kerkojne ndryrje emergjente , per shkake te amortizimit ne kohe dhe veprimit te agjenteve atmosferike, ka nevoje per nderhyrje te mirembajtjes se jashtme dhe te brendeshme

Ne keto objekte do te behen keto nderhyrje sic parashikon Rregullorja Arkitektonike e Qytetit per Bashkine Kamez

Neni 7

i) Punime të jashtme, si:

- ndërhyrjet e mirëmbajtjes së zakonshme kur sjellin ndryshime të karakteristikave, formave dhe ngjyrave ekzistuese;

- vendosja e shtresave përrritjen e eficiencës energjetike të ndërtesave ekzistuese, kryesish ne catine e objektit

ii) Punime të brendshme, si:

- përforcimi i strukturave mbajtëse të brendshme;
- hapja dhe mbyllja e dyerve të brendshme;
- krijimi, eliminimi ose ndryshimi i mureve ndarës (jombajtës) të brendshëm, i mjidiseve për shërbime higjienike;

iii) Punime të tjera, si:

- struktura që instalohen për nevoja të çastit dhe të përkohshme, pa themele, me materiale të çmontueshme, pa përdorur struktura beton-armeje, blloqe betoni, murature e soleta dhe që hiqen në çdo rast, brenda një afati kohor maksimal 6-mujor; - vendosja e paneleve diellore, fotovoltaikë, në shërbim të ndërtesave, në përputhje me rregulloren arkitektonike të qytetit dhe kufizimet që mund të rrjedhin nga legjislacioni përmbrojtjen e trashëgimisë kulturore, historike apo mjedisore;

- punime riparimi, zëvendësimi dhe mirëmbajtjeje të rrjeteve të infrastrukturës publike dhe komunikimeve elektronike, që nuk prekin sistemin konstruktiv të tyre, nuk ndryshojnë përdorimin dhe përmasat e infrastrukturës, si dhe kushtet e zhvillimit në zonën përreth;
- punime riparimi, mirëmbajtjeje dhe rehabilitimi të infrastrukturës së ujites, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja;
- ndërhyrjet me qëllim ruajtjen apo rritjen e eficiencës energetike dhe akustike në një strukturë ekzistuese, që nuk prekin sistemin konstruktiv të ndërtesës (p.sh.: ndërhyrje në themele, mure mbajtëse, tra-kolonë etj.);

Riparim dhe zevendesim I Catise dhe perfocim I struktures mbajtese te kesaj te fundit. Zevendesim I shtresave termoizoluese dhe tjegullave.

Fasadat do te suvatohen me suva te thjeshte dhe me boje hidroplastike,do kete hidroizolime per objektet qe jane me solete monolite.Do kete punime te brendeshme si shtrim pllaka gress,vendosje dyer dhe dritare, krimin e abjenteve higjeno-sanitare etj.

